



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMET PËRFUNDIMTARE
KUALIFIKIMI PROFESIONAL “SHËRBIME SOCIALE DHE
SHËNDETËSORE”

(Niveli II në KSHK, referuar niveli II në KEK)

Kodi: O-II-23

TIRANË, 2025

Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional “**Shërbime sociale dhe shëndetësore**”, **Niveli II në KSHK, referuar niveli II në KEK**, përmban temat dhe kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim profesional, të trajtuara në lëndët profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale në të dy klasat e këtij niveli.

Ky program i ndihmon individët të përqendrohen në ato njohuri (koncepte, parime, ligjësi, procedura etj.) dhe kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësimdhënësit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të individëve.

Për drejtuesit e shkollave profesionale, këto programe krijojnë mundësinë për planifikimin dhe realizimin e Provimeve Përfundimtare në nivel shkolle.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e individit në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në nivelin tjetër.

Gjatë përgatitjes së individëve për provimet përfundimtare, është e rëndësishme që herë pas here mësimdhënësit të zhvillojnë teste të nxënësve, me teste teorike apo praktike, që mund t’i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh njohuritë dhe kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

Programi orientues përbëhet nga dy pjesë:

- programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar;
- programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar.

A. Programi orientues për Provimin e Teorisë Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar në kualifikimin profesional “**Shërbime sociale dhe shëndetësore**”, **Niveli II në KSHK, referuar niveli II në KEK**, është hartuar duke u mbështetur në temat më të rëndësishme të programeve të lëndëve profesionale më përfaqësuese dhe më thelbësore, të cilat përbëjnë 35% të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

Lëndët profesionale të përzgjedhura për t’u përfshirë në provimin e teorisë profesionale dhe temat e përzgjedhura në të, janë si më poshtë:

Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues

Nr.	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Psikopedagogjia	41	19
2	Bazat e anatomisë së njeriut	73	33
3	Edukimi shëndetësor dhe higjiena	68	30
4	Barnat mjekësore dhe alternative	38	18
	TOTALI	220	100

Temat sipas lëndëve janë

a) Temat nga lënda “**Psikopedagogjia**”, kl.10 ;

Gjithsej 41 orë

Tema 2	Bazat biologjike nga konceptimi deri tek lindja	8 orë
Tema 3	Zhvillimi fiziko–motor i të porsalindurve dhe foshnjave	8 orë
Tema 6	Zhvillimi fizik i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe atyre me nevoja të veçanta	5 orë
Tema 8	Zhvillimet sociale dhe problematika e moshës së adoleshencës	4 orë
Tema 9	Marrëdhëniet njerëzore në moshën e rinisë dhe atë të mesme	4 orë
Tema 12	Shërbimet e nevojshme për individët e moshës së tretë	6 orë
Tema 13	Sëmundjet tipike të moshës së tretë	6 orë

b) Temat nga lënda “**Bazat e anatomisë së njeriut**”, kl. 10;

Gjithsej 73 orë

Tema 3	Sistemi kockor	8 orë
Tema 4	Sistemi artikular	7 orë
Tema 5	Sistemi muskular	10 orë
Tema 6	Sistemi tretës (digjektiv)	10 orë
Tema 7	Sistemi respirator	10 orë
Tema 8	Sistemi urinar	8 orë
Tema 10	Sistemi kardio-vaskular	10 orë
Tema 11	Sistemi nervor	10 orë

c) Temat nga lënda “**Edukimi shëndetësor dhe higjiena**”, kl.10 dhe 11; **Gjithsej 68 orë**

Tema 1	Shëndeti dhe modelet e tij	6 orë
Tema 2	Sëmundja dhe stadet e saj	6 orë
Tema 5	Problematikat shëndetësore sipas grup moshave	4 orë
Tema 6	Shenjat jetësore të organizmit	6 orë
Tema 7	Dhënia e ndihmës së parë	6 orë
Tema 2	Porositë dhe udhëzimet mjekësore	6 orë
Tema 3	Standardet e higjienës	6 orë

Tema 6	Sëmundjet infektive dhe rrugët e transmetimit të infeksionit	10 orë
Tema 7	Pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe ambienteve	6 orë
Tema 9	Metodat fizike të dezinfektimit dhe sterilizimit	8 orë
Tema 10	Llojet e kontaminimit dhe masat parandaluese	4 orë

d) Temat nga lënda **“Barnat mjekësore dhe alternative”**, kl. 11; **Gjithsej 38 orë**

Tema 5	Rrugët e marrjes së barnave	4 orë
Tema 9	Barnat me efekt në qarkullimin e gjakut dhe zemër	6 orë
Tema 10	Barnat me efekt në traktin e frymëmarrjes	6 orë
Tema 11	Barnat me efekt në sistemin nervor	6 orë
Tema 12	Barnat me efekt në sistemin e tretjes	6 orë
Tema 13	Barnat me efekt tek syri dhe veshi	5 orë
Tema 15	Alergjia medikamentoze dhe efektet e padëshiruara të barnave	5 orë

Udhëzime për përgatitjen e testit të provimit të teorisë profesionale:

Provimi i teorisë profesionale të integruar do të jetë me test me shkrim, i cili zgjat 1.5 (një presje pesë) dhe përgatitet nga Komisioni i Provimit Përfundimtar i kualifikimit profesional të nivelit përkatës. Për hartimin e testit komisioni mund të mbështetet edhe tek banka e testeve e përgatitur nga AKAFPK-ja. Në hartimin e testit komisioni duhet të mbajë parasysh rregullat, parimet dhe formatet, për ndërtimin e testit.

Testi duhet të përmbajë 30 njësi testi me një total prej 60 pikë. Nga këto, 20 njësi testi të jenë me zgjedhje të shumëfishtë (4 alternativa) dhe 10 të tjerat të jenë njësi testi me përgjigje të kufizuara/të mbyllura (me PO/JO; me e Vërtetë e Gabuar; me plotësim të fjalës që mungon; etj.) Testi duhet të shmang pyetjet e hapura.

Njësitë e testit duhet të jenë të niveleve të ndryshme të vështirësisë, duke ndjekur skemën me tre nivele, si më poshtë:

Model i shpërndarjes së pikëve për pyetje të niveleve të ndryshme në test

Niveli I (i ulët)	Niveli II (mesatar)	Niveli III (i lartë)
Aftësia për të rikujtuar/kuptuar/identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të zbatuar/argumentuar/shpjeguar/krahasuar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar dhe për të nxjerrë përfundime...

Ndarja e pikëve sipas peshës së çdo lënde dhe niveleve

Nr.	Lënda	Peshat e lëndëve në %	Pikët për çdo lëndë	Ndarja e pikëve sipas niveleve të vështirësisë		
				Niveli I 40% e pikëve	Niveli II 40% e pikëve	Niveli III 20% e pikëve
1	Psikopedagogjia	19	11	5	5	1
2	Bazat e anatomisë së njeriut	33	20	8	8	4
3	Edukimi shëndetësor dhe higjiena	30	18	7	7	4
4	Barnat mjekësore dhe alternative	18	11	5	5	1
	TOTALI	100%	60 pikë	24 pikë	24 pikë	12 pikë

Përcaktimi i pikëve për çdo njësi testi bëhet duke pasur parasysh tipin e njësisë së testit. Për shembull: njësitet e testit me zgjedhje të shumëfishtë marrin gjithmonë 1 (një) pikë përkundërt përgjigjes së paracaktuar të saktë; njësitet me përgjigje të hapur marrin aq pikë sa kërkesa kanë brenda tyre (duke mbajtur parasysh edhe argumentimin nga nxënësi); njësitet me përgjigje të kufizuar marrin aq pikë sa gjykohet nga grupi hartues dhe kjo lidhet me kërkesat që parashtrihen në pyetje dhe niveli i vështirësisë.

Së fundi, skema e vendosjes së notës kundrejt pikëve të fituara përcaktohet nga grupi hartues i testit. Në vijim, jepet një model i skemës së vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 10	4
11 - 15	5
16 - 20	6
21 - 30	7
31 - 40	8
41 - 50	9
51 - 60	10

B. Programi orientues për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, Niveli II në KSHK, referuar niveli II në KEK, është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

Nr.	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1.	Të realizojë dhënien e ndihmës së parë, matjen e shenjave jetësore të organizmit dhe vlerësimin e gjendjes social-shëndetësore të individit në nevojë.	Detyra 1: Dhënia e ndihmës së parë në vendngjarje, matjen e shenjave jetësore të organizmit (puls, tension arterial, temperaturë, frymëmarrje) dhe vlerësimi i gjendjes social shëndetësore të individit në nevojë.	30
2.	Të realizojë përkujdesjen trupore për individë në nevojë duke i respektuar me etikë profesionale dhe të kryejë proceset e pastrimit, dezinfektimit dhe sterilizimit duke zbatuar të gjitha masat parandaluese shëndetësore	Detyra 2: Përkujdesja trupore në përshtatje me nevojat specifike të individit duke i respektuar me etikë profesionale. Kryerja e proceseve të pastrimit të duarve pas procedurave, para shpërndarjes së ushqimit, dezinfektimit dhe sterilizimit, pajisjeve dhe orendive duke zbatuar të gjitha masat parandaluese.	30
3.	Të realizojë ushqyerjen e individit në nevojë dhe të plotësojë nevojat shëndetësore duke realizuar aktivitete edukative dhe argëtuese	Detyra 3: Ushqyerja e njeriut në nevojë në përshtatje me gjendjen e tij shëndetësore duke realizuar aktivitete edukative dhe argëtuese.	20
4.	Të realizojë leximin dhe zbatimin e recetave mjekësore dhe rekomandimeve të mjekut duke identifikuar zhvillimet kryesore të njeriut në grupmosha të ndryshme dhe të informojë familjarët për gjendjen e individit në nevojë	Detyra 4: . Leximi dhe zbatimi i recetave mjekësore e rekomandimeve të mjekut duke identifikuar zhvillimet kryesore të njeriut në grupmosha të ndryshme dhe të informojë familjarët për gjendjen e individit në nevojë.	20
Shuma			100

Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi i praktikës profesionale do të realizohet me 4 detyra praktike në kabinetin e kujdesit social-shëndetësor.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 (tri) orë, në përputhje kjo me Udhëzimin për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t'i lihet hapësirë për vlerësime edhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara.
- Është *e domosdoshme dhe shumë e rëndësishme* që për çdo detyrë, që në fillim të provimit të praktikës profesionale, nga mësuesit/instruktorët (organizatorët e provimit) t'i kushtohet vëmendje *“përcaktimit dhe zbatimit të rregullave të teknikës së sigurimit, të ruajtjes së mjedisit dhe dhënies së ndihmës së shpejtë”* gjatë gjithë kryerjes së detyrës për çdo nxënësi.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj, duke filluar nga përgatitja e vendit, mjeteve dhe pajisjeve të punës etj.
- Gjithashtu për çdo detyrë komisioni duhet të përfshijë në vlerësim një element shumë të rëndësishëm, zbatimin e rregullave të higjienës, rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.
- Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen mjete, pajisjet si dhe materialet për realizimin e këtyre detyrave.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kriteret për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme si dhe komunikimi, bashkëpunimi në grup, bashkëveprimi ndërmjet njëri tjetrit etj.
- Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për detyrën përfundimtare.
- Komisioni i provimit për secilën detyrë parapërgatit tezat e provimit, ku nxënësi në mënyrë të rastësishme zgjedh njërin prej tyre. Komisioni i provimit duhet të përgatisë paraprakisht instrumentin e vlerësimit me procedurat/hapat/etapat e kryerjes së detyrave. Komisioni nuk duhet të ndërhyjë gjatë zhvillimit të provimit.

- Vlerësimi i të gjitha detyrave bëhet me listë kontrolli në bazë të instrumenteve përkatëse të vlerësimit.

Detyra 1 do të realizohet në mjedise të simuluar në kabinetin e kujdesit social-shëndetësor. Mjetet dhe pajisjet e domosdoshme për realizimin e kësaj detyre janë: mjete ndihmëse rrethore, orë dore, kutia e ndihmës së shpejtë, aparat për matjen e tensionit arterial, termometër etj.

Nxënësit do të përdorin lojën me role, ku një nxënës i instruktuar më parë merr rolin e të dëmtuarit ndërsa nxënësi tjetër i jep ndihmën e parë.

Nxënësi duhet të japë ndihmën e parë sipas protokolleve dhe metodave të përcaktuara dhe të dokumentojë të dhëna të thjeshta në vendngjarje.

Gjatë dhënies së ndihmës së parë nxënësi vlerëson gjendjen social-shëndetësore të individit në nevojë duke dokumentuar çdo situatë.

Komisioni i provimit paraprakisht duhet të përgatisë instrumentin e vlerësimit, me përshkrime të qarta të nivelit të përmbushjes, kriteret e vlerësimit, që lidhen me dhënien e ndihmës së parë në vendngjarje dhe matjen e shenjave jetësore të organizmit (puls, tension arterial, temperaturë, frymëmarrje). Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe.

Detyra 2 do të realizohet në mjedise të simuluar në kabinetin social-shëndetësor.

Mjetet dhe pajisjet e domosdoshme për realizimin e kësaj detyre janë:

- Shtrat përkuqdesje, manekin ushtrimor, veshje, çarçaf, pampers, ujë, detergjent, legenë, lavaman shtrati, shtupa, peshqir, doreza, lavaman, autoklavë etj.

Detyra do të realizohet në shtratin e përkuqdesjes ku qëndron i shtrirë manekini.

Nxënësi do të realizojë përkuqdesjen trupore (larjen e kokës, trungut, gjymtyrëve, ndërrimin e pampersit, ndërrimin e çarçafëve etj.) pastrimin e duarve, largimin e mbetjeve dhe materialeve të përdorura, sterilizimin e mjeteve të përdorura duke zbatuar të gjitha masat parandaluese shëndetësore.

Komisioni i provimit paraprakisht duhet të përgatisë instrumentin e vlerësimit, me përshkrime të qarta të nivelit të përmbushjes, kriteret e vlerësimit, që lidhen me përkuqdesjen trupore në përshtatje me nevojat specifike të individit, kryerja e proceseve të pastrimit të duarve pas procedurave, para shpërndarjes së ushqimit, dezinfektimit dhe sterilizimit, pajisjeve dhe orendive. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe.

Detyra 3 do të realizohet në mjedise të simuluar në kabinetin e shërbimit social-shëndetësor.

Mjetet dhe pajisjet e domosdoshme për realizimin e kësaj detyre janë:

- Komplet pjatash, tasa, gota, lugë, pirunë, thika, pipa, peceta, peshqirë, tavolinë, shtrat, jastëk, solucion larës;
- Pajisjet dhe artikujt sanitarë të nevojshëm për zhveshjen, larjen, dhe veshjen e individit në nevojë social-shëndetësore etj.

Nxënësit do të vlerësohen, gjatë realizimit të kësaj detyre, nëpërmjet lojës me role, ku një nxënës i instruktuar më parë merr rolin e individit në nevojë, ndërsa nxënësi tjetër realizon

ushqyerjen e njeriut në nevojë në përshtatje me gjendjen e tij shëndetësore duke realizuar aktivitete edukative dhe argëtuese.

Gjatë realizimit të kësaj detyre nxënësi duhet të komunikojë vazhdimisht me etikë profesionale me individin në nevojë, për ta informuar mbi procedurën që do të kryejë duke vlerësuar rëndësinë e aktiviteteve edukative dhe argëtuese.

Komisioni i provimit paraprakisht duhet të përgatisë instrumentin e vlerësimit, me përshkrime të qarta të nivelit të përmbushjes, kriteret e vlerësimit, që lidhen me ushqyerjen e njeriut në nevojë në përshtatje me gjendjen e tij shëndetësore, duke realizuar aktivitete edukative dhe argëtuese.

Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe.

Detyra 4 do të realizohet në mjedise të simuluar në kabinetin e shërbimit social-shëndetësor.

Mjetet dhe pajisjet e domosdoshme për realizimin e kësaj detyre janë:

- Kartelë mjekësore, recetë, formularë të ndryshëm etj.

Nxënësit do të vlerësohen, gjatë realizimit të kësaj detyre, nëpërmjet lojës me role, ku një nxënës i instruktuar më parë merr rolin e individit në nevojë, ndërsa nxënësi tjetër realizon leximin dhe zbatimin e recetave mjekësore dhe rekomandimeve të mjekut duke identifikuar zhvillimet kryesore të njeriut në grupmosha të ndryshme dhe të informojë familjarët për gjendjen e individit në nevojë.

Komisioni përgatit paraprakisht disa situata të simuluar, të individëve në nevojë, të grupmoshave të ndryshme, ku nxënësi përzgjedh në mënyrë rastësore njërin prej tyre. Në varësi të situatës, nxënësi informon familjarët mbi gjendjen e përgjithshme të individit në nevojë.

Në rolin e familjarit mund të bëhet një anëtar i komisionit ose një nxënës i instruktuar më parë në rolin e tij.

Komisioni i provimit paraprakisht duhet të përgatisë instrumentin e vlerësimit, me përshkrime të qarta të nivelit të përmbushjes, kriteret e vlerësimit, që lidhen me ndërtimin e marrëdhënies punonjës-familjar. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe.